



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2023:163446

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766207

C.nr. 712/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.B nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.T avokat nga Prishtina rruga "...", kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, jashtë seance me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.B nga Vushtrria.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, paditëses Sh.B, për periudhën nga data 18.04.2021 e deri me datë 20.11.2022 (gjithsejtë 332 ditë pune), t'ia paguaj shumën prej 664.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (27.07.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses Sh.B, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të për përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Paditësja Sh.B nga Vushtrria, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. L.T nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 27.07.2023, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën nga data 18.04.2021 e deri me datë 20.11.2022 (gjithsejtë 332 ditë pune), në shumën prej 664.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë (27.07.2023), e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me të dhunshëm.

Gjykata me aktvendimin C.nr.712/23 të datës 08.05.2024, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 13.05.2024, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 20.05.2024.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se të paditurës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore, sepse nuk është palë që ka marrë obligime, se e paditura nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet e detyrimeve dhe nuk ka marr obligime për ti përmbushur kërkesat e paditëses, andaj nga kjo arsye gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seance pasi që në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga theksimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga Kontrata Nr.139/15 e datës 23.09.2015 dhe nga Vërtetimi Nr.65 i lëshuar me datë 11.05.2023, nga Drejtoria e Arsimit-SHFMU "M..." *fshati* -Vushtrri.

Kontestuese nuk ishte prania në punë e paditëses nga data 18.04.2021 e deri me datë 20.11.2022 (gjithsejtë 332 ditë pune), pasi që ky fakt është provuar nga Vërtetimi Nr.65 i lëshuar me datë 11.05.2023, nga Drejtoria e Arsimit-SHFMU "M..." *fshati* -Vushtrri.

Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë, paditëses nuk ia ka bërë kompensimin e ushqimit në punë.

Kontestuese nga e paditura ishte mungesa e legjitimacionit pasiv për të qenë palë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënjen e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ku është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, si dhe nga Vërtetimi Nr.65 i lëshuar me datë 11.05.2023, nga Drejtoria e Arsimit-SHFMU ”M...” fshati -Vushtrri, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është e bazuar, andaj edhe ia njohu shumën prej 664.00 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2,00 euro (332 x 2 =664.00).

Sa i përket pretendimit të të paditurës se i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore, gjykata gjeti se ky pretendim është i pa bazuar për arsye se konform nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, punëdhënësi ka për obligim të sigurojë kompensim për ushqim për ditët e pranisë në punë, e që në këtë rast punëdhënësi për paditësen nuk është ndonjë organ apo institucion tjetër shtetëror, por është këtu e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim. Andaj, gjykata në këtë rast vlerëson se e paditura e ka legjitimacionin pasiv në këtë çështje.

Gjykata, përveç kërkesës kryesore paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë (27.07.2023), e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kamatën, me numër 265/2020, i datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së, duke ia njohur paditëses shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.712/23, me datë 31.05.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.